




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Zyra e Kryetarit të Komunës

Nr. 02/Zyrtarisht

Datë: 03.06.2020

Bazuar në nenin 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, pika 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149, dhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077, Kryetari i Komunës shpall:

KONKURS

(Për kryerjen e punëve për shërbime të veçanta)

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Titulli i vendit të punës: Zyrtar Anketues-Evidentues për Pronat e Paluajtshme

Numri i ekzekutuesve: dhjetë (10)

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta (kohëzgjatja 6 muaj)

Orari i plotë: 40 orë në javë

Paga: 300 euro Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrin, pëlqimin për planin e punës dhe afatet me udhëheqësin dhe stafin profesional për zbatimin e detyrave, shërbimeve lidhur me evidentimin e pronës së paluajtshme;
- Bene identifikimin e pronave të paluajtshme, të pa regjistruara dhe pronareve apo shfrytëzuesve të atyre pronave dhe i shënojnë në formularin e anketimit;
- Verifikon dhe krahason, të dhënat e vendosura në sistem përmes formularëve të anketimit dhe ri anketimit me gjendjen ekzistuese në teren;
- Identifikon pronaret të cilëve u adresohen faturat tatimore dhe vërejtje të tjera si dhe marrin nënshkrimet e pranuesve të faturave;
- Kryen vizita në pronat ndërtimore në teren, shënon Nr. e Fletës Poseduese dhe Nr. e Ngastrës, lokacionin dhe adresën dhe ruan të dhënat në bazën e të dhënave;
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret, të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohe pas kohe nga mbikëqyrësi.

Shkollimi, aftësi përvojë dhe attribute tjera që kërkohen:

- Diplomë Universitar
- Njohuri lidhur me procedurat standarde, administrative-teknike në një fushe të njohur teknike ose administrative;
- Shkathësi të mira komunikuese, negocuese dhe bindëse;
- Njohuri në aplikimet e programeve: Word, Excel Power Point dhe Intranet.
- Posedim i Patentë Shoferit i dëshirueshëm.

Aktet Ligjore dhe nen ligjore, që rregullojnë rekrutimin, përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke zbatuar një procedure të thjeshtësuar të rekrutimit.

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e shpalljes publike, nga data: 03.06.2020 deri 10.06.2020.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit: **Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit, ekstraktin e lindjes, dëshmi për përvojën e punës nëse ka, kopja e Patentë Shoferit nëse ka, Dëshmi që nuk është nën hetime,** duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.

Kryetari i Komunës:

Bashkim RAMOSAJ